



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 15, Datë 27.01.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SH.P.K. PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 27.01.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/3 prot., datë 26.01.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 341, datë 21.12.2022 ka vendosur të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 23.12.2022 dhe 24.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 01.01.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 2015/3 prot., datë 30.12.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 82 prot., datë 11.01.2023, nr. 82/1 prot., datë 20.01.2023, dhe 82/3 prot., datë 25.01.2023.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.
- Nga vlerësimi i këtij aplikimi rezulton se nuk është depozituar ende vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) për administratorin e shoqërisë, por është dokumentuar aplikimi përkatës për marrjen e këtij vërtetimi.
- Duke qenë se ky vërtetimi lëshohet nga një organ tjetër dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Amministrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike deri në 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja dijani e vendimit.
-

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë vendimmarrjen bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike deri në 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja dijani e vendimit.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI